



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i procesverbalit i Dëgjimit Publik për planifikimin e buxhetit, mbajtur më 13.7.2024, duke filluar nga ora 14:00. Kryetarët e bashkësive, lagjeve dhe fshatrave të Komunës së Prishtinës.

Në mbledhje morën pjesë: Alban Zogaj-nënkryetari, Osman Bllaca-kryesuesi, Valbona Makolli- drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Krenar Xhaferi- drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale, Lulzim Fushtica- drejtor i Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencë, Muhedin Nushi- drejtor i Drejtorisë së Administratës, Adelina Sahiti- drejtoreshë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Arlinda Zeqiri- zyrtare në Drejtorinë e Administratës, Fadil Leci- shef i bashkësive lokale.

Të pranishëm ishin edhe qytetarët: Dren Shahini, Riza Ilazi, Fluturim Rexha, Osman Dragusha, Ramadan Bllaca, Amir Simnica, Çerçiz Lutolli, Bahri Gashi, Bahri Sejdiu, Gresa Neziri, Meriton Osmani, Donjeta Dragusha, Ragip Lutolli, Besim Krasniqi, Naim Gashi, Samir Haliti, Sadije Ajeti, Ekrem Bahtiri, Nazmi Hasani, Avdi Aliu, Arlinda, Visare, Berat Rrustolli, Drini Hoxha, Naser Sopjani, Durim Berisha, Gani Dobratiqi dhe Rifat Gashi.

Osman Bllaca, kryesues:- hapi diskutimin e katërt për buxhetin për vitin 2024, i cili ka të bëjë me kryetarët e bashkësive lokale dhe tha se e kemi bërë praktikë që një diskutim të tillë ta mbajmë çdoherë para çdo hartimi të buxhetit.

Dren Shahini, banor i lagjes “Mati”, “Lagjes së Spitalit” tha se kanë ardhur ta ngritin zërin e protestës në mënyrën më paqësore dhe demokratike për të treguar që më 4.11.2022 tetë muaj më parë “Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me GIZ Kosova ka përfunduar analizën e lokacionit për vendosjen e kontejnerëve në lagjen tonë, ku pas analizës janë propozuar edhe lokacione tjera potenciale dhe numri optimal i kontejnerëve. Takimi është mbajtur më 9.11.2022 me organizimin tonë, me prezencën e nënkryetares Sahatqiu dhe Ilirik Musliut – Drejtorja e Shërbimeve Publike, drejtori e cila e ka këtë problematikën tonë. Ai tha se është vapë, kanë filluar ditët e verës dhe ne aty jemi duke jetuar në një deponi mbeturinash, kundërmimi është i jashtëzakonshëm. Na është premtuar 8 muaj më parë që ky problem do të zgjidhet shumë shpejtë dhe prej asaj dite injorim total, as s’ka shtim të kapacitetit të kontejnerëve, as s’ka ndryshuar orari i mbledhjes së mbeturinave. Injorim i vazhdueshëm nga drejtorja në fjalë dhe nga instancat komunale të cilët i kemi ftuar të debatojmë dhe të gjejmë zgjidhje, mos i bëni gabimet që i kanë bërë paraparakët tuaj të cilët në mandatin e tyre 8 vjeçar vetëm njëherë kanë qenë për ta vizituar lagjen, kurse fatkeqësisht ju se keni vizituar ende si qeverisje e re dhe pa ardhur me vizituar nuk

mund t'i njihni problematikat. I vetmi drejtor që po angazhohet është Krenar Xhaferi, të cilit ia kemi lodhur kokën edhe për probleme tjera duke ia adresuar. Ky problem është urgjent, unë e di Komuna në të kaluarën ka bërë zgjidhje për probleme tjera dhe e ka ngritë në nivel urgjence çështjen e kanalizimit z. Muhedin e di. Ju lutem ngritne në prioritet sepse po duam zgjidhje të problemit sepse shumë lehtë do të na shfaqet ndonjë epidemi, rrugët kundërmojnë, dritaret

s'mund të hapen, është fat që në këtë vapë nuk ka nxënës dhe janë në pushim përndryshe ata kalojnë nëpër këta kontejnerë, të madhësisë enorme. Ai tha se ka muaj që nuk e ndjejnë dorën e Komunës në lagjen e tyre, ku tani ka filluar aneksi i Shkollës "Pavarësia", që është premtuar se do të përfundojë në shtator, por që nuk do të përfundohet dhe kjo do të jetë problematika tjetër për të cilën ata do të vijnë në Komunë por urgjente për ta është çështja e mbeturinave.

Alban Zogaj: nënkryetari përshëndeti të gjithë, edhe ata që kanë ardhur të protestojnë në formën e tyre duke thënë i thënë qytetarit që në të gjitha është i saktë përveç aty ku thotë që nuk e kanë vizituar lagjen pasi që si ai vetë, po ashtu edhe Kryetari dhe drejtorët me dhjetëra herë kanë vizituar lagjen, duke thënë se edhe ai përballet me atë pamje, pasi që jeton aty afër, por është një problem i trashëguar të cilin po mundohen ta zgjidhin. Ai theksoi se pastrimi menaxhohet nga një Ndërmarrje Publike Regjionale, që ka shumë probleme pasi që Prishtina grumbullon mbeturina me vetëm me dhjetë kamionë, disa prej të cilëve gjysmakë, dhe për ta zgjidhur këtë, nënkryetari tha se kanë ndërmarrë hapa si: kanë shpallur tenderin për blerjen e kontejnerëve, kamionëve të rinj në mënyrë që të përmirësohet situata. Tutje z. Zogaj tha se duhet pas parasysh se viti 2022 ka qenë vit ku kanë administruar një buxhet të planifikuar prej një administrate tjetër dhe s'ka pas linjë buxhetore për të blerë as kamionë, as kontejnerë dhe se viti 2023 është viti i buxhetit të tyre ku janë planifikuar katër milionë euro për blerjen e kontejnerëve dhe kamionëve, por 10 kamionë të rinj nuk mjaftojnë, pasi që për ta mbuluar Prishtinën nevojiten 50 kamionë. Ai tha se do të kërkojnë nga qytetarët që t'i përfundojnë pagesat, e ndoshta edhe të rritet pak çmimi, pra edhe të ofrohet shërbim cilësor edhe të mblidhen të hyra sepse nuk funksionojnë njëra pa tjetrën.

Dren Shahini:- tha se ai dhe të tjerët që janë aktiv në lagje i dinë problematikat e prokurimit, e mosbuxhetimit, mbajtjes së fondit, por çështja e vizitës sipas tij nuk është veç për të vizituar, por për të mbajtur mbledhje dhe takime me qytetarë.

Krenar Xhaferi, drejtor: - tha se ndarjen zonale të qytetit e kanë planifikuar nga maji i vitit të kaluar, por rialokimin e mjeteve nga niveli qendror nuk e kanë pas deri në fund të vitit, e as bartjen e mjeteve në të cilën është planifikuar një ndarje zonale për lagjen "Mat" vetëm një kompani e cila i trajton pjesën e gropave. Ai theksoi se këto situata nuk po tejkalohen e kontratat nuk po nënshkruhen, projektet po ndalen në gjysmë, pikërisht nga ato probleme me nivelin qendror, për më shumë se 1 vit e 1 muaj.

Dren Shahini: - tha se është e tmerrshme me pas dikë brenda të sëmurë e mos me mund me hap dritaren nga kundërmimet, si dhe dha përkrahjen e tij për të trokitur në dyert e instancave qendrore, për t'u zgjidhur problemet.

Osman Bllaca, kryesues: - vazhdoi me procedurat e diskutimit, duke ia dhënë fjalën drejtores Valbona Makolli për një rezymë lidhur me buxhetin për bashkësitë lokale.

Valbona Makolli, drejtoreshë: - falënderoi të pranishmit duke njoftuar se pas Qarkores së parë të marrë nga Ministria e Financave, Kryeqyteti për vitin 2024 do të ketë në dispozicion 122.790.872 euro (Njëqind e njëzet e dy milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy), kurse të hyrat vetanake të cilat Komuna është e obliguar t'i mbledhë gjatë këtij viti janë 38.778.000 euro (tridhjetë e tetë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë). Ajo tha për të interesuarit se në web-faqen e Komunës gjendet materiali ku janë të gjitha projektet për investimet kapitale, të cilat janë propozuar për vitin 2024 dhe parashikimet për vitin 2025-2026.

Osman Billaca, kryesues: - para se të fillojë debatin paraqiti një kërkesë nga Qerim Sharbani, kryetar i bashkësisë lokale për fshatrat, Sharban, Rimanishtë, Siqevë dhe fshatrat tjera përreth, i cili kërkon 300.000 euro (treqind mijë) për rrugët dhe rrugicat e asaj bashkësie lokale dhe atyre fshatrave të cilat janë përreth.

Osman Dragusha, i porsazgjedhur në zgjedhjet e fundit nga bashkësia lokale e Prugovcit: - tha se kërkesat që kanë qenë në të kaluarën dhe që janë në shqyrtim shpreson të zgjidhen duke filluar me kërkesat për 5 lagjet e Prugovcit. Ai tha se për lagjen e parë rruga ka qenë kërkesë e vazhdueshme që disa vite rresht, e cila është dëmtuar nga ujësjellësi dhe asnjëherë nuk është intervenuar për t'i sanuar dëmet e po ashtu mungon edhe trotuari. Z. Dragusha përmendi pronën e Komunës rreth lumit "Llap", me sipërfaqe diku 6 hektarë, që dikur ka qenë qendra rekreative edhe për vetë Prishtinën dhe sot më shumë i një deponie të mbeturinave, dhe se duhet të ndërmerret diçka. Në lagjen e dytë është kërkuar intervenim në rrugë sepse edhe aty janë dëmtuar, tek e treta ka mungesë të ndriçimit, tek lagjia e katërt ku është edhe shkolla për shkak të rrezikut nga komunikacioni ai kërkoi që të vendosen policët e shtrirë. Ai tha se tek lagjia e pestë po ashtu ka uzurpim të pronës, aty ku është objekti që është shfrytëzuar për bashkësi lokale synojnë që aty të ndërtohet edhe një çerdhe. Ai po ashtu përmendi edhe një vend që të gjithë e njohin si "Te bunari", pjesa ku lidhet rruga Milloshevë për Podujevë dhe kthehet për Barilevë, duke thënë se aty është një vend ku vërtet ka frekuentim dhe lëvizje të madhe dhe për hir të sigurisë kërkohet që të ketë një rrethorullim. Ai pati një kërkesë për autobusë në atë vijë Prishtinë-Lupç, pasi që është shumë e nevojshme si për nxënës ashtu edhe për ata që punojnë dhe se edhe nëse s'ka mundësi me bë lëvizje të shpeshtë si nëpër qytet, të paktën të këtë qarkullim në mëngjes kur frekuentimi i nxënësve është më i madh nga ora 06:00-08:00, në mesditë nga ora 12:00-14:00 dhe në mbrëmje me pas së paku deri në orën 23:00 edhe një autobus për t'i kthyer ata nxënës, studentë dhe ata që punojnë nëpër kompani private.

Krenar Xhaferi, drejtor: - tha se tek pjesa e Prugovcit, e kanë nënshkruar një kontratë, në të cilën komplet planifikimet e kryetarëve të bashkësive lokale të kaluar, janë futur si pjesë e investimit dhe se kontrata është nënshkruar, e në javën tjetër më së largu do të fillojnë punimet në një pjesë të saj. Një rrugë tjetër e cila ka qenë kërkesë e kamotshme e banorëve nga Bardhoshi, në Prugovcin 5 dhe Barilevë, pra rruga "Mallakastra" drejtori tregoi se është nënshkruar. Drejtori po ashtu theksoi se në kuadër të ndarjes zonale të planifikuar vitin e kaluar, prej majit të vitit të kaluar, deri në fund të vitit nuk e kanë marrë ligjshmërinë e alokimit të mjeteve, pastaj ka kaluar në kuadër të mjeteve dhe kurrë më herët nuk ka ndodhë që deri në këtë muaj të ketë vonesa të bartjes së mjeteve, ai tha se është një situatë në të cilën po përballen me nivelin qendror në formën më të padrejtë të mundshme, në kuadër të së cilës është ndarja zonale e cila do t'i trajtojë gropat në kuadër të fshatrave. Pra drejtori tha se të gjitha këto gropat që nuk janë trajtuar me vite të tëra, është planifikuar që më afër 500.000 euro (pesëqind mijë) të trajtohen gropat edhe rrugica të vogla me asfalt, e po ashtu në kuadër të saj 1.000.000 euro (një milion) trajtim të rrugëve me zhavorr në fshatrat e Komunës së Prishtinës, por sipas drejtorit ata

nuk e kanë marrë ka 1 vit e 1 muaj ligjshmërinë për trajtimin e këtyre problemeve, pra 100 km rrugë mbesin pa u trajtuar, pikërisht për shkak të këtij problemi.

Naser Sopjani, avokat nga Grashtica: tha se e ka parë që po planifikohet ndërtimi i kanalizimit dhe deshi të dijë rruga "Gurakuqi" dhe "Qerreti" a janë pjesë e ndonjërit nga projektet e Prishtinës, sepse në faqen zyrtare të 2016-tës, më 5 dhjetor thuhet se është bërë ndriçimi publik në Grashticë, që ka përfunduar, jo që është bërë, por që është kryer faza e dytë e ndriçimit publik. Ai mohoi këtë, duke thënë që në Grashticë nuk ka ndriçim publik. Ai tha se që prej shitores deri në Stallovë rruga "Gurakuqi" që shkon nga shkolla dhe rruga "Qerreti" janë pa kanalizim, pa ujësjellës, pa ndriçim, duke thënë se mos po kalojnë disi gabimisht këto projekte, Grashticë po njihet njëra rrugë e Grashticës dhe po thuhet që është kryer e gjithë Grashtica. Z. Sopjani tha se nëse shkon në ora 21:00 në Grashticë, tek shkolla në Grashticë deri në Stallovë, Keqekollë e ke terr, prej Makovcit ndalen dritat, kryhen shtëpitë e pastaj rrugë terri. Ai u interesua edhe për kanalizimin duke marrë shkas nga njoftimi që është bërë në shkurt të vitit 2023 duke pyetur se a e rrokë atë pjesë kanalizimi, apo se rrokë hiç vetëm kalon e shkon tjetër kah, sepse sipas tij "po mbesin si zorrë qorre".

Krenar Xhaferi, drejtor: u përgjigj duke thënë që këtë pjesë të rrugëve e kanë pas që në 2022 ose t'i vazhdojnë ato projekte, ose t'i ndërprejnë dhe t'i rialokojnë, e rialokimin nuk e kanë marrë për 1 vit e 1 muaj, duke thënë që i kanë vazhduar ato projekte që kanë qenë për mos me bërë këtë bllokadën dhe me ecë me investime. Ai tha se kanë lidh një kontratë të kanalizimit afër 800.000 euro (tetëqind mijë), në Grashticë, Mramor, dhe se për ta parë a është saktë ajo pjesë apo jo, drejtori ftoi qytetarin në drejtorinë e Investimeve Kapitale në takim për ta hapur hartën dhe për të diskutuar për pjesën e investimeve. Ai ceku edhe rrugën nga "Bajram Bahtiri", e cila lidhet nga banesat sociale, në drejtim të Llukarit sepse ajo pjesë hyn në këtë pjesë edhe që nëse nuk e kanë marrë ligjshmërinë për vazhdimin e atij projekti. Ai tha se kjo është një situatë e papranueshme sepse kontrata, pret në tavolinën e kryetarit, me muaj të tërë për t'u nënshkruar, e për shkak të ligjshmërisë nga niveli qendror, e që e drejta është në anën tonë, e kanë pranuar edhe ata më në fund, por ai "enteri" i kalimit të mjeteve nuk ka kaluar dhe ne po ballafaqohemi me këtë problem. Drejtori tha se kjo do ta kishe lehtësuar pak këtë pjesën sepse nga "Bajram Bahtiri", kanë kontratën gati në vazhdim, me një rrugë me tri korsi, është e menduar të jetë me katër korsi, por do të jetë me tri, në kuptimin e asaj që kurdo që planifikohet në të ardhmen mund të vendoset me katër korsi për t'u vazhduar tutje deri në Grashticë. Për kanalizim të pjesës së Grashticës, drejtori tha se kanë ndarë, diku mbi 400.000-500.000 euro (katërqind mijë-pesëqind mijë), për të vazhduar në pjesën e Mramorit, jo nga ana e Mramorit, por në Mramor.

Alban Zogaj, nënkryetar: - falënderoi të gjithë për këtë diskutim, por theksoi që qëllimi i këtij dëgjimi publik lidhet me buxhetin e vitit 2024, andaj këtu është mirë që banorët me dhënë propozime të reja në mënyrë që me marrë shënime.

Riza Ilazi, nga fshati Ballaban, përkatësisht lagjja e sipërme që quhet Ballabani i Epërm, rruga "Brahim Beka": - falënderoi Drejtorinë e Investimeve Kapitale që vitin e kaluar dhe sivjet është përfunduar 1100 metra (njëmijë e njëqind) rrugë, e asfaltuar me standarde me të mira që mund të ekzistojnë, mirëpo ai tha se në fshat s'mund të hyjnë, në shtëpi tona s'mund të shkojmë, toka s'mund të punojmë se edhe 1 kilometër është e pakalueshme. Ai tha se kur ka të reshura me shi e borë, e vërshon uji prej fshatit Nishevc, prej kufirit me Serbi dhe bartë gjithçka me vete, prandaj e kanë frikën që edhe nëse shtrohet me zhavorr, edhe nëse nuk punohet mirë me kanale do ta bartë prapë. Z. Ilazi tha se, nëse deri në 2024-tën nuk shtrohen ato 1 kilometër rrugë, atëherë asgjë nuk është bërë, veç kanë mbetur të izoluar, siç kanë mbet në të gjitha qeveritë komunale.

Ai tha se i ka me shkrim 20 kërkesa për qeveritë e mëparshme kur ka qenë Shpend Ahmeti, dhe kurrë njeri i gjallë s'ka dalë për t'i vizituar. Për deri tash sa është punuar, vitin e kaluar dhe sivjet ai është përjetësisht falënderues, por ka mbet në gjysmë dhe se nëse mbet për 2024-tën edhe ato pak shtëpi që kanë mbet, kanë me dalë.

Krenar Xhaferi, drejtor: - tha se e kanë vizituar atë rrugë e cila është në gjendje të mjerueshme dhe se është planifikuar, siç e ceku edhe më herët që në kuadër të trajtimit të rrugëve me zhavorr, janë planifikuar 1 milion euro, që i bie 100 km rrugë, e ideja ka qenë që të trajtohet me gjeotekstil, të ketë kanale anësore, me shtesa dhe të kemi një trajtim pak më të veçantë në krahasim me trajtimet të cilat kanë ndodh. Edhe ky projekt sipas tij është në tavolinën e kryetarit për nënshkrim si kontratë dhe presim kalimin e bartjes së mjeteve 28.5 milionë euro, të cilat janë bllokuar në nivel qendror dhe nuk po lëshohen, për shkak të pikëpamjes politike, por që shpreson që deri në fund të korrikut do të kalojë dhe kontrata do të nënshkruhet, për t'u vazhduar pastaj me punë.

Avdi Aliu, përfaqësues i fshatit Keqekollë: - tha se Keqekolla është pjesë e bashkësisë lokale të Keqekollës, që përfshin Keqekollën, Ballabanin, Nishevcin dhe Prapashticën. Ai tha se për 5-6 vite sa është kryetar i fshatit ka bërë me dhjetëra kërkesa, të cilat mu kanë refuzuar në mungesë të mjeteve financiare, por ai tha se nuk është që s'është punuar, sidomos në Gollak, mirëpo sipas tij si fshat Keqekolla është anashkaluar. Ai tha se Kryetari u ka premtuar për rrugën me zhavorr, mirëpo aty janë dy-tri lagje që janë biznese atje, janë dy ferma në lagjen e "Qelajve" dhe në lagjen "Miftaraj" dhe ai u lut që të vizitohen për ta shikuar se në çfarë rruge kalojnë ata çdo ditë për ta dërguar qumështin nëpër qumështore. Ai tha se janë diku rreth 15 rrugë, 6 janë trajtuar por nuk prekin lagjet ku jetojnë njerëzit, rrugët që kalojnë nëpër Keqekollë, p.sh rruga për Stallovë, Marec e disa rrugë anash, mirëpo Keqekolla është lënë anash dhe u lutur për vitin e ardhshëm të hidhen në buxhet.

Krenar Xhaferi, drejtor:- tha se shumicën e kërkesave të secilit i ka vizituar dhe problemi kryesor qëndron që kur shkon aty duhet me pas një kontratë prapa e cila ta reflekton atë situatë. Ai ritheksoi se kontrata është menduar prej 1 vit e 1 muaj dhe është shumë e padrejtë ndaj Komunës së Prishtinës, që po bllokohet puna kështu nga niveli qendror. Ai tha se është hera e parë që është ndarë një buxhet i tillë nga Kuvendi Komunal, janë ndarë 1 milion pikërisht për arsye për t'i trajtuar, që njerëzit mos të kenë situata të tilla. Drejtori u shpreh se ndarja me zhavorr veç është planifikuar dhe do të harmonizohen me bashkësitë lokale për trajtimin e atyre rrugëve.

Avdyl Aliu: - tha se lagjja "Miftari" është trajtuar me zhavorr por konfiguracioni i relievit me një shi me një reshje të madhe po i shkatërron. Lagjja "Qelaj", është shtruar dy herë nga pak duke apeluar që të vazhdohen ato, e mundësisht me u fut në buxhet me u asfaltuar, lagjja "Spahija" ose rruga "Albanët", dhe të shkohet për t'i parë rrugët si janë pasi që nuk mundesh as këmbë me ec në ato rrugë e le ma me mjete.

Krenar Xhaferi, drejtor: - prapë ceku bartjen e mjeteve, e cila kurrë nuk është vonuar kaq, dhe se nëse kishte kaluar bartja e mjeteve në mars, prill, maj, tani do të ishin 100 kilometra rrugë të fshatrave duke i trajtuar me zhavorr, por sipas tij kjo situatë e vonësive është pa koment.

Sabedin Hasani, kryetar i bashkësisë lokale qendra, bëri disa kërkesa si në vijim.

Nën 1. ai tha të bëhet të bëhet ndriçimi i tuneleve në “Zonën Qendra”, dhe ngjyrosja e tyre. Tjetra kërkesë është në rrugën “Simon Shiroka dhe Nurie Zeka”, ku sipas tij duhet të bëhet ndërrimi i gypave të kanalizimit dhe i ujësjellësit, pasi që kompania kur e ka bërë shtrimin e asfaltit rrugës aty janë shtyp disa dhe tash po rrjedh dhe po kundërmon. Po ashtu ai tha se është hera e tretë që kanë një kërkesë që në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, në objektin e Pediatriisë dhe të Gjinekologjisë të vendoset një ashensor. Tjetër kërkesë e z. Hasani ishte që të rregullohet së paku një fushë në Zonën Qendra, që do t’u shërbejë të rinjve për lojëra futbollit, basketbollit etj. Ai po ashtu propozoi që ashensorët që janë të vjetër që nga vitet 1970 dhe janë akoma në përdorim nga banorët dhe që paraqesin rrezik për sigurinë e qytetarëve në bashkëfinancim me banorët të ndërrohen dhe të vendosen të rinj. Tjetër kërkesë e tij ishin shkallët për dalje emergjente, si dhe hidrantë funksional për fikje të zjarrit.

Krenar Xhaferi, drejtor: tha se e kanë nënshkruar një kontratë, mbas “Zahir Pajazitit”, ku është një kanalizim i tmerrshëm, i cili bashkë me rrugën “Rexhep Luci”, është edhe ai kanalizim i cili do të trajtohet. Po ashtu ai tha se kanë planifikuar vitin tjetër që të gjitha rrugicat e rrugës në shesh të cilat lidhen me i trajtuar, me e rregulluar pjesën e kanalizimit edhe me i trajtuar pastaj me kalldrëm, shumicën e rrugëve të cilat lidhen me pjesën e “Sheshit”, duke thënë që e shënoi edhe rrugën “Simon Shiroka”, për ta pasur parasysh për ta trajtuar.

Lulzim Fushtica, drejtor: - tha se Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia, është drejtori që është krijuar para 4 muajve dhe se janë këtu për t’i dëgjuar për të bërë pastaj planifikimin buxhetor të vitit 2024 me i fut të gjitha brengat sa i përket aspektit të sigurisë dhe emergjencave dhe kjo i përfshin edhe daljet emergjente, hidrantët, planet emergjente, përgatitjet për vërshime dhe për të gjitha gjërat që prekin sigurinë, si publike, si fizike, të qytetareve të kryeqytetit.

Osman Dragusha, pyeti se a funksionon ende shtabi emergjent në kuadër të bashkësive lokale.

Lulzim Fushtica, drejtor: - tha se do ta rifunksionalizojnë tash me formimin e bashkësive lokale ku është paraparë që në çdo bashkësi lokale të ketë edhe njësi vullnetare të zjarrfikësve, trajnimin edhe formimin e njësive vullnetare të zjarrfikësve që do të ndihmojnë jo vetëm në zjarr, por në të gjitha fatkeqësitë tjera të shkaktuara nga natyra apo edhe nga dora e njeriut.

Ramadan Bllaca, qytetar i Komunës së Prishtinës: - tha se ka një problem në fshatin Besi, e pasi që aty po u mungon rruga e cila ka filluar me Isa Mustafën, ka mbetur gjysmë për 600 apo 700 metra atje. Ai propozoi që rruga e lagjes Bllaca e fshatit Besi, të fillojë të ndërtohet prej Lebanës deri të lagjja e tyre.

Krenar Xhaferi, drejtor:- tha se e ka parë gjendjen dhe u ka premtuar në kuadër të rrugëve me zhavorr, për ta trajtuar atë pjesë dhe se ende jemi pritje të asaj kontrate, por ai tha se si ta kenë kontratën menjëherë do të fillojnë punën, kështu që në momentin që ta kemi menjëherë të fillojmë punën.

Flutrim Rexha, nga fshati Rimanishtë: - paraqiti disa kërkesa që kërkojnë vëmendjen e menjëhershme, që kanë të bëjnë me kanalizimin dhe ujësjellësin në fshatin Rimanishtë, ku sipas tij kanalizimi rrjedh nëpër tokat bujqësore, gjë që e shkakton edhe kontaminimin e tokës edhe ajo tokë shndërrohet në tokë jopjellore. Ai tha se jetojmë në kohën e inteligjencës artificiale, ndërsa fshati Rimanishtë nuk ka as kanalizim as ujësjellës, rruga kryesore e fshatit është në gjendje të mjerueshme, është e ngushtë edhe me shkurre përreth, pra është në formën e një tuneli. Po ashtu ai theksoi se shkolla ka nevojë për investime bazike dhe qytetarët e fshatit kanë marrë një iniciativë për renovimin e Xhamisë me mjete vetanake, gjë që kishte qenë mirë dhe e udhës që edhe Komuna ta japë kontributin e saj kur e dimë që buxheti i Komunës rrjedh nga tatimpaguesit.

Krenar Xhaferi, drejtor: - tha se kanë kontraktuar kompaninë e cila duhet të punojë rrjetin e kanalizimit në fshatin Rimanishtë, por shiu nuk i ka lejuar të punohet dhe se është çështje ditësh në të cilën do të startohet edhe do të finalizohet tërë projekti sa i përket rrjetit të kanalizimit fekal. Ai tha se një rrugë e cila do të trajtohet në kuadër të buxhetit që ka qenë pjesë e buxhetit në vitin 2021-2022, është shumë e vërtetë, pjesa e rrugës kryesore është shumë e dëmtuar dhe se ka kërkuar që të ndajmë mjete për ta futur si pjesë të buxhetit në shtator këtë vit. Sa i përket rrjetit të ujësjellësit ai tha se janë dukë punuar dhe është fat i mirë ndoshta në krejt këtë luftë që kemi me nivelin qendror, te rrjeti i ujësjellësit e kemi njëfarë koordinimi me Ministrinë e Ekonomisë dhe me Ministrinë e Ambientit, që të bëjmë një fizibilitet për fshatrat e Gollakut, e kemi punuar draftin e parë, gjatë javës tjetër vetëm kanë me u takuar këto si me thënë Komuna me Ministrinë, bashkë edhe me pjesën e disa përfaqësuesve të cilët i kemi marrë nga fshatrat e Gollakut dhe i kemi dhënë prioritet në këtë kuptim që nëse Rimanishta mund të lidhet në rrjetin e ujësjellësit, “KUR Prishtinës”, atëherë ta kemi së edhe “KUR Prishtina”, është pjesë e asaj si me thënë paneli të cilën po diskutojmë si ta zgjedhim këtë problem. Nëse “KUR Prishtina”, pranon së bashku me Ministrinë ta lidhim në rrjetin e ujësjellësit sepse është shumë afër pjesa ku mund të lidhet, atëherë atë pjesë ta lidhim ose pjesën e Mramorit, ndërsa kjo do të jetë pjesë e diskutimit të këtij fizibiliteti për të cilin e kemi marrë premtimin edhe nga Ministria e Ambientit, që ata do t’i ndajmë në shtator mjetet, ndërsa ne i kemi vetëm 300 mijë euro të cilat mund t’i hedhim, për ta bërë një studim për krejt fshatrat.

Osman Billaca, kryesues: - mbylli diskutimin për të lënë takim sërish në diskutimin e radhës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Dëgjim publik për planifikimin e buxhetit për vitin 2024;

13.07.2023

Ora 14:00

Kryeqyteti - Prishtinë / Kuvendi Komunal

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Gjinia	Titulli/Title	e-mail	Nënshkrimi/Signature
1	Liza Jlaza					
2	Filipina Rexha					
3	OSMAN	DRAGUŠHA				
4	RAMDAN	BLLACA				
5	AMIR	SIMNICA				
6	GERGJIS	LUTOČI				
7	BAHRI	GASHI				
8	Behri	Sejdizi				
9	DREN	SHAHINI				
10	GRESA	NEZIRI				

*P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do*

të përdoren për qëllime tjera!

Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	Gjinia	e-mail	Nënshkrimi/Signature
11	MERTON	OSMANI				
12	Donjeta	Dragusha				
13	Paqije P	Zhetko				
14	Besim	KRASHI				
15	NAIH	GASHI				
16	SAMIR	HALIM				
17	SADISO	BEI				
18	ERREN	BASHIRI				
19	NAZMI	Hasani				
20	AVDI	ALI U				
21	ARZINDA	KOSTI				
22	WALID	GONDI				
23						
24						U
25						
26						
27						
28						
<p>P.S *Të dhënat tuaja personale do të përdoren vetëm për qëllime të evidentimit të pjesëmarrësve në konsultim publik dhe nuk do të përdoren për qëllime tjera!</p> <p>*Pjesëmarrësit janë të njoftuar se gjatë diskutimeve publike, do të fotografohet dhe do të publikohen!*</p>						

Nr.	Emri/Name	Mbiemri/Surname	Titulli/Title	Gjinia	e-mail	Nënshkrimi/Signature
29	Blindon S.	Sylaj				
30	BERAT	RAUSTOCI				
31	Drini	Hoxha				
32	Naser	Sopçari				
33	DURIM	BEKISHI				
34	Goni Delenaj	Delenaj				
35	Rifat	genci				
36						
37						X
38						